

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kurti njofton identifikimin e tri viktimave nga “Grupi i Intelektualëve
ADRESA	https://albeu.com/kosove/kurti-njofton-identifikimin-e-tri-viktimave-nga-grupi-i-intelek-tualeve/1018678/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 12:28:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 12:26:21 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b341190380600a8eae0d8cf7438b326223f9cfa27e1707eed53b940535449cea
TEKSTI	bf37908391f771099b73ad41be0e2d57ffdc3bc73f5771854956c1de8de75313
PAMJA	ee0ab4a79636e76fe4dfcc88c73275d8c5fe8c58bb7a51b1be48660c17e06f3d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9017fe709b2fa81f0507a73f3fbd8410e651c10876c7181390bb70d6d7b41885
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aea7d85c4e1ffedb330a4f0c595bceb62319ead8019dd1bf570799cb9f2d4d85
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.


<https://scan.stamles.eu/verify/9017fe709b2fa81f0507a73f3fbd8410e651c10876c7181390bb70d6d7b41885>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kurti njofton identifikimin e tri viktimave nga "Grupi i Intelektualëve"



Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, bëri të ditur se janë dorëzuar tri raportet e para të ADN-së për mostrat e mbetjeve mortore të nxjerra nga varret masive në Kalludër dhe Jabukë të Zubin Potokut.

Rezultatet e analizave kanë përcaktuar identitetin e tri viktimave dhe kanë konfirmuar lidhjen e tyre me të ashtuquajturin "Grupi i Intelektualëve". Ky grup përbëhej kryesisht nga qytetarë të Skenderajt dhe Mitrovicës, të cilët u rrëmbyen dhe u zhdukën me dhunë nga forcat serbe më 19 prill 1999.

Kurti tregoi se lajmin nga Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur e mori në fillim të vizitës së tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sipas tij, raportet janë pranuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur.

Identifikimi i tri viktimave është bërë në më pak se dy muaj nga konfirmimi i varrit të parë masiv. Raportet e ADN-së i janë përcjellë Institutit për Mjekësi Ligjore, ndërsa përfaqësuesit e këtij institucioni dhe të Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur i kanë informuar menjëherë, gjatë ditës së sotme, familjet e viktimave të identifikuar.

Në ditët dhe javët e ardhshme pritet të mbërrijnë edhe raportet për mostrat e tjera të dërguara për identifikim përmes ADN-së. Kurti shprehu shpresën që familjet e tjera të marrin përgjigjet të cilat i presin prej 27 vitesh, duke theksuar se, ndonëse asnjë përgjigje nuk e largon dhimbjen e humbjes, njohja e së vërtetës i jep fund ankthit të pritjes për fatin e njerëzve të dashur.

Gjetja e varrit masiv në Kalludër ishte konfirmuar më 27 korrik. Gjatë vizitës së tij në atë vend, Kurti kishte kërkuar që faktorët ndërkombëtarë, në veçanti Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar dhe Bashkimi Evropian, ta rrisin trysinë ndaj Serbisë për zbatimin e Deklaratës për Personat e Zhdukur, për të cilën palët u dakorduan më 2 maj 2023 në Bruksel.

Ai vecoi nevojën për hapjen e menjëhershme të arkivave, duke përfshirë edhe atë të Brigadës së 37-të të

të fundit /



Dënimi i 4 ish-krerëve të UÇK-së, Erion Veliq: Do t'i propozoj Këshill...



Aktivisti në Milano kërkon qeveri teknike dhe paralajmëron gre...



Aksidenti tragjik në Venecia, taksisti hetohet pas vdekjes ...



Lloga pas aktgjykimit të Hagës: Shfuqizimi i Gjykatës Speciale...



Ndryshimet në qeveri, Berisha sulmon Ramën: Kontrollon...



Vendim i papritur në Kategorinë e Parë, Oriku ndërpret...



Hansi Flick kërkon që Barcelona të ndjekë sulmuesin që po...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Motorizuar të Ushtrisë Jugosllave. Sipas Kurtit, kjo brigadë ka kryer masakra në Kosovë, posaçërisht në Drenicë, ndërsa Serbia e ka klasifikuar dokumentacionin e saj në vitin 2014 për një periudhë prej tridhjetë vjetësh.

Kryeministri në detyrë deklaroi se angazhimi institucional do të vijojë përmes kërkimeve në terren, përkrahjes së procesit të identifikimit dhe komunikimit të drejtpërdrejtë e të kujdesshëm me familjet. Ai premtoi se institucionet do të qëndrojnë pranë tyre dhe do t'i mbështesin në kërkesat për të vërtetën, drejtësinë dhe kthimin me dinjitet të më të dashurve.

Sipas Kurtit, sqarimi i fatit të secilit person të zhdukur me dhunë përbën një prioritet shtetëror për Republikën e Kosovës dhe një detyrim njerëzor, i cili nuk mund të konsiderohet i përfunduar për sa kohë që edhe një familje e vetme vazhdon të presë përgjigje.

Ai tha se e vërteta për fatin e të zhdukurve dhe drejtësia për viktimat e familjet e tyre do të mbeten në qendër të angazhimit të tij dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si në punën e përditshme, ashtu edhe gjatë vizitës në Shtetet e Bashkuara dhe takimeve në kuadër të sesionit të 81-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

Kurti nënvizoi se pjesë e pandashme e kësaj agjende do të jetë kërkesa drejtuar Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Evropian dhe Mbretërisë së Bashkuar që të ushtrojnë më shumë trysni mbi Serbinë. Synimi është që ajo të përbushë zotimet e marra, të hapë arkivat dhe të ofrojë informacionet e nevojshme për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur me dhunë.

Shtuar më 19.09.2026 14:26

Tags: [kurti](#), [masive](#), [varreza](#)



Lloga pas aktgjykimit të Hagës: Shfuqizimi i Gjykatës Speciale është...



Liria ka Emër" paralajmëron vazhdimin e protestës sonite në Prishtinë



Imzot Dodë Gjergji reagon për vendimin ndaj ish-drejtimesve të UÇK-së:...



Altin Krasniqi: Dënimi me 25 vjet është shumë i rëndë, babai mund të mo...



Berisha kërkon seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit pas vendimit të...



Jashari kërkon anëtarësimin e Kosovës me të drejta të plota në Kartë...



FSK-ja zhvillon ushtrimin "Valor Shield 2026" me ushtritë e SHBA-së,...



Përpjekja për grusht shteti do të dështojë", Naim Miftari reagon ndaj sulme...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.